



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 48, datë 27.02.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “STRUKTURË
HOTELIERIE “VILLAS OF LIVADH”, ME 1 DHE 2 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE
NËNTOKË, ME PISHINA DHE MUR RRETHUES”, ME VENDNDODHJE NË
LIVADH, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Himara Construction” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Strukturë hotelierie “Villas of Livadh”, me 1 dhe 2 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, me pishina dhe mur rrethues”, me vendndodhje në Livadh, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Himara Construction” sh.p.k
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë;
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDJ RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 10/12/2025